



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Në/Dana <u>17.03.2024</u> vit/god			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vrednues
<u>02-</u>	<u>035/02-</u>		<u>205</u>



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 6 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në shqyrtim publik draft rregullore për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë.

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në shqyrtim publik draft rregullore për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Propozimi në shqyrtim publik i draft rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë do të jepet në shqyrtim publik nga data 01.04.2024 deri me datën 30.04.2024, Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së shqyrtimit publik ne zyrën e drejtorisë së Inspeksionit tek Shtëpia e Kulturës së Komunës të Vitisë zyra nr. 08, kati i dytë si dhe në forme elektronike munde të dërgohen në emalin adresën Faton.Ahmeti@rks-gov.net, dokumenti gjendet në web faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 06.05.2024 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për draft rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë.

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti

